



Ky projekt financohet
Nga Bashkimi Evropian



Festohet e promovohet Dita Nderkombetare e Rojeve Mjedisore

Ditën e diel , datë 31 Korrik 2016, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Rojeve Mjedisore, në shëtitoren e qytetit të Beratit, në një nga standat e panairit të organizuar nga Bashkia Berat, u prezantua puna e bërë nga Rengersat e Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Berat (AdZM- Berat).

Pamjet e bukura të zonave të mbrojtura, që janë të shumta në Qarkun e Beratit, standat e bukura, fletëpalosjet e shpërndara, tërhoqën mjaft vizitorë të shumtë, të cilët bashkebiseduan me mjaft interes mbi punën e sjell para syve të qytetarëve.

Në mbështetje të punës së palodhur, e të vështirë të Rojeve Mjedisore, u bashkua me promocionin e saj edhe organizata “Për Mirëqënie Sociale dhe Mjedisore” Berat, e cila është duke zbatuar projektin “ Reduktimi i Krimit Mjedisor në Parkun Komëtar të Tomorrit”, financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit ACHIEVE- REC Shqipëri. Nga bashkëbisedimi me Renger-sat mësuam më shumë mbi Zonat e Mbrojtura, shtrirjen e tyre në Qarkun e Beratit, shumëllojshmërinë e florës e faunës në këto zona, por edhe për dëmin e madh që I ka sjellë veprimtaria njerëzore e qellimtë, joshur nga dëshira për të fituar sa më shumë në kurriz të natyrës.

Steda me larminë e informacionit e profesionalizmin e inspektorëve të AdZM, tërhoqi mjaft vizitorë, e më të spikaturit ishin fëmijët e moshave të ndryshme, të cilët me dëshirën për të qenë pjesë e natyrës e të së bukurës, vizatuan me bojëra vetë natyrën e mjedisin. Gjithashtu interesi I të huajve që vizitonin qytetin ishte shumë I madh krahas qytetarëve berats.

Ky aktivitet u krye në bashkëpunim me AKZM dhe projektin Natyra 2000.

Materiali u punua nga Erjola Azizolli dhe Fatos Nako- Drejtor I AdZM-së Berat

“Për Mirëqënie Sociale dhe Mjedisore Berat”

www.natyraberat.org

Kutia postare Nr 4

Tel; 0695539321

L Mangalem, Berat

“Ky projekt zbatohet nga organizata “Për Mirëqënie Sociale dhe Mjedisore” në kuadër të programit ACHIEVE.





Ky projekt financohet
Nga Bashkimi Evropian



“Ky projekt zbatohet nga organizata “Për Mireqenie Sociale dhe Mjedisore” në kuadër të programit ACHIEVE.





Ky projekt financohet
Nga Bashkimi Evropian



“Ky projekt zbatohet nga organizata “Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore” në kuadër të programit ACHIEVE.

